



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 38

Tiranë – E hënë, 12 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 710, datë 1.12.2022	Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.. 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22591, datë 9.12.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara..... 5

**URDHËR****Nr. 710, datë 1.12.2022**

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES
SË PËRFAQËSUESVE TË
INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË NË KËSHILLIN KONSULTATIV
PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË
VOGLA DHE TË MESME, MËNYRËN E
VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE
AFATIN E DORËZIMIT TË
DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjës “e”, të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”; të pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për përfaqësuesit e IAL-ve në Këshillin Konsultativ të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme”.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, për përfaqësues të IAL-ve në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme është data 15.12.2022.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për përzgjedhjen e përfaqësuesve të IAL-ve

në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFAQËSUESVE
TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË
LARTË, NË KËSHILLIN KONSULTATIV
PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA
DHE TË MESME**

Në zbatim të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”; të vendimit nr. 541, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, si dhe për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Këshillit Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme”; dhe të urdhrit nr. 710, datë 1.12.2022, të MAS-it, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit dhe Sportit shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së përfaqësuesve të IAL-ve në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (Këshilli Konsultativ për NMVM-të), si më poshtë:

Nr.	Institucioni i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve përfaqësues të IAL-ve
1	Institucioni publik i arsimit të lartë	- 1 (një) përfaqësues
2	Institucioni jopublik i arsimit të lartë	- 1 (një) përfaqësues



1. Përshkrim i përgjithshëm

Këshilli Konsultativ për NMVM-të është organ këshillimor dhe transparence, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e ekonomisë, me përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.

Këshilli kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përbëhet nga 11 anëtarë me eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet në fushën e ekonomisë dhe në mbështetjen e zhvillimit të biznesit, si më poshtë:

a) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë;

b) 1 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e sipërmarrjes;

c) 1 përfaqësues nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;

ç) 1 përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

d) 3 përfaqësues të sipërmarrjes dhe të biznesit, të përzgjedhur nga organizatat dhe dhomat më të përfaqësuara të tregtisë dhe të biznesit;

dh) 1 përfaqësues nga Shoqata e Bankave;

e) 2 përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë, nga të cilët një përfaqësues nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe një përfaqësues nga institucionet jopublike të arsimit të lartë;

ë) 1 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të propozuar nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Anëtarët e Këshillit emërohen me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë pas propozimit nga institucionet apo organizatat e parashikuara, për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.

2. Kompetencat e Këshillit Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

Këshilli Konsultativ për NMVM-të ushtron kompetencat e mëposhtme:

- diskuton çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;

- jep mendime dhe këshilla për mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;

- këshillon për mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve.

3. Kërkesat e pranimit:

a) të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;

b) të pranojnë në mënyrë vullnetare të jenë anëtarë të Këshillit Konsultativ;

c) të kenë aftësi të mira komunikimi dhe mund të kontribuojnë në propozimin për përmirësimin e klimës së biznesit;

d) të jenë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre si anëtarë të Këshillit Konsultativ.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit:

- kërkesë për aplikim, ku të jetë specifikuar IAL-ja që kandidati do të përfaqësojë;

- jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV–*Curriculum Vitae*);

- fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i njohjes dhe i njësimi të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- fotokopje të librezës së punës;

- fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;

- vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;

- formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;

- vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/1.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të jetë deri në datën 15.12.2022, në një nga këto mënyra:

a) me postë zyrtare në adresë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve të përzgjedhur

- Përzgjedhja e kandidatëve për përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme kryhet nga një komision *ad hoc* i ngritur



me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur, brenda 10 ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit do të shpallë kandidatët e përzgjedhur në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

SHTOJCA NR. 1/1

VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), në Këshillin Konsultativ për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, autorizoj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrim _____

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)		Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Objekt+truall			Data	Ora	Vendi
1	Bar-Restaurant-Hotel "Ador", nr. pasurie 32/24 (truall + ndërtesë)	Rinas, Krujë	82 000 000	82 000 000	3320	638	21.12.2022	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është

NJOFTIM
Nr. 22591, datë 9.12.2022

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes", kapitulli III, pika 16, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, "Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara", shpallet për shitje me publikim 10-ditor, si më poshtë:

në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrues brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e



Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:
www.financa.gov.al.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022